



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	19. 09 2023	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicims Quantity
6156/2023			1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1108/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1108/2023 të datës 24.08.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted], kundër organit të punësimit Komuna e Drenasit, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.09.2023, morri këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.1108/2023 e datës 24.08.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Nëpunësja civile [redacted] e punësuar në Komunën e Drenasit sipas Akt Emërimit AE.01Nr.06-070/01-20390 të datës 27.12.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër veprimit administrativ të Komunës së Drenasit, lidhur me kategorizimin e pozitës së saj në Kategorinë Profesionale 2.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Drenasit, ndërsa me datë 06.09.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Akt e Emërimit AE.01Nr.06-070/01-20390 të datës 27.12.2022, rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtar për Shërbime Sociale 2" në Qendrën për Punë Sociale, në kuadër të Komunës së Drenasit me koeficient të pagës shtatë pikë pesë (7.5), sipas sistemit të vjetër të pagave.

Ankuesja, me datë 24.08.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komuna e Drenasit pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, e ka kategorizuar ankuesen në Kategorinë Profesionale 2, me koeficienti të pagës katër pikë nëntëdhjetë e pesë (4.95), ndërsa e njëjta ka kërkuar ndryshimin nga kategoria aktuale në Kategorinë Profesionale 1.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Drenasit, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit VNr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankueses lidhur me kategorizimin e pozitës së saj në kategorinë *Profesional 2* është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritior, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me



lartë, ankueses i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.1108/2023.**

**Ilire MEHMETI-SHAQIR**

*Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional*

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses [REDACTED]
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunë e Drenasit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

